



PRANUAR MË
ACCEPTED ON
PRIMLJENO.

02/05/2024

M. P. Nr. 02/

02/194



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë: 29.04.2024

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt, e mbajtur me datë: 19.01.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/159 datë: 12.02.2024, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKS-së për vitin 2024.
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 21.02.2024 dhe filloi në ora: 09:50. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Gentianë Hoti përfaqësuesi nga OSBE Sead Raba dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi 5 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Me arsye mungon Hamit Lima. A dëshiron dikush fjalën për rendin e ditës?

Nëse nuk ka diskutues shkojmë në votim. Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Pika parë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt, e mbajtur me datë: 19.01.2024. Nëse nuk ka diskutues e hedhim në votim. Kush është

për miratimin e procesverbalit?

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Pika e dytë është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/159 datë:12.02.2024, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike. Kjo kërkesë është nga kryetari i komunës. E keni materialin për të gjitha parcelat për të cilat është planifikuar që këto prona të jenë në listë për miratim, e më pastaj përmes shprehjes së interesit palët kanë mundësi t'i kërkojnë në periudhë afatgjate. Gjithsej janë nëntë prona dhe kjo listë është sikur lista e pronave, është votim në parim dhe pastaj për secilën kërkesë të palëve formohet komisioni në kuadër të saj dhe bënë vlerësimin e kërkesës së palës të cilët paraqesin interes për ta marr në shfrytëzim. Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam lexuar dhe disa janë dhe të pa njohura për ne, ku janë në cilin vend janë. Ajo çka më intereson është se a janë të gjitha këto prona në atë listën që e kemi votuar paraprakisht.

Argjend Thaçi: Po të gjitha janë sepse është e pamundur nëse nuk ekzistojnë në listën bazë, nuk mundën me qenë në këtë listë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë.

Gentianë Hoti: Atëherë është mirë të kaloj në kuvend.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi: Unë mendoj që ka qenë mirë të vijë këtu çdo kërkesë një nga një.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Dhe unë i bashkangjitem mendimit të Sadikit që më mirë do ishte të na vijë një nga një. E dimë që në kuvend do të shqyrtohen një nga një, mirëpo si KPF-ë po kritikohemi për vendimet që po i marrim që pse nuk i keni analizuar mirë. Në kuvend të merret më seriozisht dhe të sillet një nga një.

Argjend Thaçi: Të gjitha parcelat janë me fletë poseduese. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam dy qështje për t'i diskutuar në lidhje me kërkesën. Pajtoj me gjithë kolegët parafolës që nuk shkon kështu që shabllon janë dërguar të gjitha në PDF dhe e dyta është që përveq dhënies në shfrytëzim, nuk ka arsyetim pse. Kërkojnë me dhënë në shfrytëzim, mirëpo cili është investori që po e kërkon këtë. Janë një numër parcela të pronave publike që i kanë kërkuar, por nuk ka arsyeshmëri pse dëshirojnë me i dhënë. Ne nuk mundemi me marr një vendim me dhënë tokën në shfrytëzim pa e ditur për kënd po e japim dhe për qka. Vjen kërkesa e një investitorit që ka me ndërtu ose me bërë një biznes, ne e analizojmë dhe pastaj ose e votojmë ose e kundërshtojmë. Vetëm janë caktuar pronat, i kemi dhe certifikatat e këtyre pronave, por nuk kemi arsyeshmëri pse po i duhen komunës dhe për çka do ti jap në shfrytëzim. Për këtë arsye unë mendoj që nuk duhet me dërgu në kuvend.

për miratimin e procesverbalit?

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Pika e dytë është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/159 datë:12.02.2024, për inicimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike. Kjo kërkesë është nga kryetari i komunës. E keni materialin për të gjitha parcelat për të cilat është planifikuar që këto prona të jenë në listë për miratim, e më pastaj përmes shprehjes së interesit palët kanë mundësi t'i kërkojnë në periudhë afatgjate. Gjithsej janë nëntë prona dhe kjo listë është sikur lista e pronave, është votim në parim dhe pastaj për secilën kërkesë të palëve formohet komisioni në kuadër të saj dhe bënë vlerësimin e kërkesës së palës të cilët paraqesin interes për ta marr në shfrytëzim. Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Përsëndetje për të gjithë!

Unë e kam lexuar dhe disa janë dhe të pa njohura për ne, ku janë në cilin vend janë. Ajo çka më intereson është se a janë të gjitha këto prona në atë listën që e kemi votuar paraprakisht.

Argjend Thaçi: Po të gjitha janë sepse është e pamundur nëse nuk ekzistojnë në listën bazë, nuk mundën me qenë në këtë listë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë.

Gentianë Hoti: Atëherë është mirë të kaloj në kuvend.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi: Unë mendoj që ka qenë mirë të vijë këtu çdo kërkesë një nga një.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Dhe unë i bashkangjitem mendimit të Sadikut që më mirë do ishte të na vijë një nga një. E dimë që në kuvend do të shqyrtohen një nga një, mirëpo si KPF-e po kritikohemi për vendimet që po i marrim që pse nuk i keni analizuar mirë. Në kuvend të merret më seriozisht dhe të sillet një nga një.

Argjend Thaçi: Të gjitha parcelat janë me fletë poseduese. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përsëndetje për të gjithë!

Unë kam dy qështje për t'i diskutuar në lidhje me kërkesën. Pajtoj me gjithë kolegët parafolës që nuk shkon kështu që shabllon janë dërguar të gjitha në PDF dhe e dyta është që përveq dhënies në shfrytëzim, nuk ka arsyetim pse. Kërkojnë me dhënë në shfrytëzim, mirëpo cili është investori që po e kërkon këtë. Janë një numër parcela të pronave publike që i kanë kërkuar, por nuk ka arsyeshmëri pse dëshirojnë me i dhënë. Ne nuk mundemi me marr një vendim me dhënë tokën në shfrytëzim pa e ditur për kënd po e japim dhe për çka. Vjen kërkesa e një investitorit që ka me ndërtu ose me bërë një biznes, ne e analizojmë dhe pastaj ose e votojmë ose e kundërshtojmë. Vetëm janë caktuar pronat, i kemi dhe certifikatat e këtyre pronave, por nuk kemi arsyeshmëri pse po i duhen komunës dhe për çka do ti jap në shfrytëzim. Për këtë arsye unë mendoj që nuk duhet me dërgu në kuvend.

Argjend Thaçi: Veton, kjo është listë për të cilën nuk mundesh të paragjykosësh kush ka me marr. Kjo është thirrje sikurse listën e pronave që e kemi bërë në dhjetor. Kjo listë në parim do të votohet pastaj formohet komisioni pikërisht në mbledhjen e ardhshme për dhënien në shfrytëzim dhe komisioni për ankesa. Komisioni për dhënien në shfrytëzim do t'i vlerëson dhe prapë do të vijë në kuvend për me u votu. Ti je duke bërë thirrje për pronat e komunës që komuna ka interes.

Sadik Vrenezi: Shumica e këtyre parcelave janë të klasit të pestë-kullosa, askujt nuk i hynë në shfrytëzim kjo. Kjo prona në Marali është një kullos.

Argjend Thaçi: Ka investitor të kategorive të ndryshme.

Veton Zogaj: Për këtë pikë të rendit të ditës jam konsultuar dhe me grupin tim dhe me kolegët e opozitës dhe ne parimisht jemi që asnjë kërkesë që vjen nga zyra e kryetarit nuk kalon nga ne, përderisa qeverisja komunale nuk e kryen obligimin që e kanë ndaj komisioneve dhe anëtarëve të komiteteve.

Argjend Thaçi: Unë tre komisioni i kam dërguar për një formë të pagesës përmes pagave për të cilën kanë pretenduar më herët mirëpo nuk kanë mundur. Kanë ardhur në një përfundim mos me u pagu prej mallra dhe shërbime por përmes listës së pagave. Tri komisione i kemi dërguar te kryetari që të nxirret vendim për zotim të mjeteve. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Dhe ne e kemi këtë shqetësim dhe pse janë bërë shumë komisione për pagesa, kemi planifikuar në dhjetor me i përfundu obligimet mirëpo 647.000.000E përmbarusit i kanë marrë për mësimdhënës, 200.000.000E prej tyre janë në pjesën e kategorisë mallrave dhe shërbimeve që më herët i kemi paguar. Ligji pagave ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2023, i cili e specifikon se si duhet të paguhet. Na ka ardhur dhe një formular që pagesat e komisioneve të formuara qoftë nga Kuvendi apo prej grupeve punuese tjera, kryesuesi i komitetit duhet të bëjë kërkesë pas përfundimit kryetarit me shumën e medijëve që i keni dhe kryetari nxerr vendim për shpenzim. Ai vendim vjen te financat dhe anëtarët e komiteteve që janë në listë të pagave duhet të paguhet nga kategoria e pagave dhe shtesave. Shpresoj që do i përfundojmë shumë shpejtë, sepse kategorisë së pagave dhe e shtesave pikërisht për këtë punë i kemi lënë mjete më shumë.

Argjend Thaçi: Drejtor, nuk bënë pa u përfunduar pagesat.

Veton Zogaj: Ne e kemi marrur një vendim 30.000.00E për me i ridestinu disa mjete prej të hyrave vetanake dhe njerëzit që i kemi në këto Komitet po pyesin se ju e keni ndarë buxhetin dhe pse nuk janë paguar.

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës nr.01/159 datë:12.02.2024. për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike?

Për:3

Kundër: 2

Abstënim:0

Me 3 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim kjo pikë rekomandohet për Kuvend.
Kalojmë në pikën e tretë shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2023. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Sipas të dhënave të prezentuara në tabelat përkatëse del se K.K-Malishevë ka një buxhet të miratur nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal-2023, në shumën prej 18,124,837.00€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj i shtohen bartjet e disa shumave të vogla të donacioneve të mbetura nga vitet e kaluara në shumë prej 1,140.35€ të regjistruara në SIMFK, del se shuma totale e buxhetit është 18,125,977.35€. Kësaj shume i shtohet edhe shuma prej 1,212,816.35€ rritje e pagave sipas ligjit të pagave, 286,373.78€ të hyrat e bartura nga viti 2022, si dhe tejkalimi i të hyrave vetanake për 599,263.12€, del se buxheti i tërsishëm i futur në SIMFK si buxhet aktual përfundimtar kap shumën prej 20,224,430.60€.-

Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar (alokuar) për periudhën janar-dhjetor 2023 është $(20,013,872.10/20,224,428.60) \times 100 = 99\%$. Pra THV të gjithëmbarshme në këtë periudhë të realizuara kapin shumën prej 1,945,760.66€
Një përmirsim në faqen e dytë ku është 1,945,760.66/1,758,603.00, jo 1,758,603.00 por 1,158,603.00 sepse ky është planifikimi. Kur është kalkuluar ka dalë 111%, ndërsa realizimi është 167%. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë prapë po filloj me anën pozitive të Raportit kjo që na gëzon të gjithë neve si banorë të Komunës së Malishevës, tek të hyrat kemi dukshëm përmirsim. Disa vërejtje i kam tek disa kategori që ndoshta kanë të hyra mirëpo në Raport po mungojnë. Qiraja për objektet publike në vitin 2022 kemi pasur 9,027.00E, ndërsa në vitin 2023 nuk kemi fare. Taksa për parkim publik, ne nuk e di a kemi ndonjë parkim publik e kemi zero ndërsa në vitin 2022 ka qenë 210E. Zero e kemi dhe tek inspektoriati sanitar është e çuditërisht sepse ne shohim çdo ditë që operatorët ekonomik të paktën këto bizneset të gastronomisë që operojnë në Malishevë dhe nuk i kanë kushtet dhe zero nuk mundet me qenë. Të hyrat nga agjensioni i pyjeve e kemi zero çdo herë, mirëpo me arsyet që i kemi marrë herën e kalume nga drejtori i bujqësisë i cili ka thënë që mjetet kalojnë në nivelin qendror të Agjensioni i pyjeve, na kthejnë mirëpo duhet me figurë si të hyra kur të kthehen ato në buxhetin tonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi: Te shpenzimet e ndryshme intelektuale i kemi 87,790.56E në krahasim me vitin e kaluar që kanë qenë vetëm 28,310.00E. Shpenzimet kontraktuese tjera 681,389.10E në krahasim me vitin 2022 që janë 285,763.95E, është një diferencë kogja e madhe. Paisje specialistike mjeksore në vitin 2022 kanë qenë zero ndërsa në vitin 2023 kanë qenë 106,814.56E. Furnizim me ushqim dhe pije jo DK qka i bjen kjo. Furnizim me veshmbathje, për qfarë veshmbathje është fjala. Dreka zyrtare 29,363.00E, e kalkulova për 12 muaj rreth 2400E dreka zyrtare dhe mendoj që është shumë e madhe.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Te të hyrat unë para mbledhjes isha në takim me zyrtarin për të hyra dhe ZKF për tu shqaruar qështjen e unrefave por dhe mu u përgatite për qështjen e certifikatave të lindjes. Arkatari shumicën e të hyrava i fut në certifikatat e tjera dhe certifikatën e lindjes e fut në certifikata të tjera dhe totali i shumë pastaj mua po më dalin dy lloj të hyra. Më mirë është që ose do e bëjmë të gjitha te certifikata tjera ose do ti specifikojmë. E njëjta gjë është dhe te qështja e qirave, te qiraja për objekte këtu i kemi disa kategori të të hyrave që i kemi prej qirave. Nuk është qështja te bazeni sepse krijojm të hyra dhe prej objekteve të tjera. Kur e keni marrur vendim për me dhënë në shfrytëzim Bazenin e Bajës e keni dhënë për dy vite dhe ai si operator shfrytëzues e ka përfunduar obligimin e tij komplet brenda vitit 2022 pa dalur në vitin 2023, obligimin e dy viteve e ka kryer në fillim dhe për këtë këtu munden me figurë si të hyra zero në vitin 2023. Këto banesat sociale kanë obligim me pagu qiranë simbolike një pjesë e tyre nuk përgjigjen. Kemi të hyra dhe prej operatorit të ipkos që i kemi antenat në prona publike.

Veton Zogaj: Në të ardhmen është mirë me u specifiku si kategori, mos të lihen të tjera sepse nuk po e dimë çka përfshijnë në të tjera.

Blerim Thaçi: Te qështja e të hyrave nga inspektimi sanitar, mirëpo nëse e bënë inspektimi Avuk ose të tjerat të gjitha gjobat si në trafik, në gjykatë shkojnë lartë dhe kthen te ne mbi bazën e numrit të banorëve. Pra hynë në këtë pjesën e gjobave në gjykata ose gjobat në trafik. Shërbimet e ndryshme intelektuale është qështja e trajnimeve dhe pjesa më e madhe e shpenzimit janë konsulentët që i kemi të angazhuan në stafin komunal dhe kemi shërbime intelektuale me operator që i kemi disa shërbime në shëndetësi dhe paguhen nga kjo kategori. Shërbime specialistike mjeksore i kemi dy, ato që janë nën 1000E dhe ato që janë mbi 1000E. Në vlerën 1000E janë paisje teknike dhe pjesë të tjera të ilaqeve.

Veton Zogaj: A hynë këtu dhe ndihmat që po i japim për rastet e sëmundjeve.

Blerim Thaçi: Jo ato hyjnë te subvensionet. Furnizim me ushqim dhe pije jo DK, këtë vit janë bërë 3 çerdhe. Kemi obligime dhe të vitit të kaluar dhe hyjnë në kuadër të shpenzimit të vitit 2023. Furnizime me veshmbathje i kemi katër kategori, zjarrëfiksët, sigurimin, inspektoriatin, tatimin në pronë dhe këtu hynë dhe shëndetësia uniforma, mbuloja. Drekat zyrtaret nuk diktohen kryesisht veq nga ne, varësisht nga organizimi, pritjeve dhe aktiviteteve.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend, Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2023?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKS-së për vitin 2024.

Kush është që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë te pika e kërkesave. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ne gjithmonë jemi duke marrë vërejtje nga kolegët tonë asamblistë në asamble për kërkesa. Pasi është drejtori këtu duhet ta dimë a kemi buxhet mos të dërgojm kërkesa që nuk mundemi me i mbulu.

Gentianë Hoti: Ne po i klasifikojm në bazë të moshës.

Blerim Thaçi: Një pjesë e subvencioneve është shfrytëzuar nga përmbarusit. Kemi vendime të vitit kalim që ende nuk janë përfunduar. Kur ta bëjmë tejkalimin e të hyrave atëherë jemi të detyruar për me nda dhe një pjesë shtesë të subvencioneve.

Argjend Thaçi: Prof. nga 3 raste nga 1500E po i dërgojmë në kuvend për gjithë vitin 50,000.00E bëhen.

Rukije Bytyqi: Ka kërkesa dhe të muajve tjerë që nuk janë dalë mjetet.

Argjend Thaçi: Kërkesa e parë është parashtruar nga Jemin Thaçi të cilit i kemi ndihmuar në muajin e tetë dhe nuk mundemi me trajtu prapë këtë kërkesë e kërkesat tjera të vitit të kalim me i lënë sepse nuk kemi kapacitet. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet?

Me vota unanime kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nga Idriz Kryeziu personi në fjalë ka ndërruar jetë dhe këtë kërkesë do e refuzojmë. Kush është për që kjo kërkesë të refuzohet?

Me vota unanime kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nga Donjetë Mazreku, e cila kërkon ndihmë financiare për djalin e saj 3 vjeçar Teo Kryeziu për të cilin kërkohet trajtim jashtë vendit dhe shuma e kërkuar është 50,000.00E. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Arlind Kastrati, i cili është me sëmundjen e kancerit. Kush është për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Florentinë Krasniqi e cila është me kancer.

Kush është për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për kuvend.

Kërkesë tjetër është nga Arben Berisha, i cili kërkon ndihmë për Aron Berisha i cili ka nevojë për operacion kirurgjikal në zemër për të cilin kërkohen 5.000E.

Kërkesa tjetër është nga Faton Thaçi, i cili kërkon ndihmë për vajzën e tij.

Gentianë Hoti: Këtë kërkesën me 5,000E dhe tjetrën me 3,000 e kisha dërguar tek kryetari ja ndan shumën më të madhe.

Argjend Thaçi: Kush është për që Arben Berisha dhe Faton Thaçi të dërgohen tek kryetari?

Me vota unanime këto kërkesa rekomandohen te kryetari.

Kërkesa tjetër është nga Ajet Berisha, janë disa familje që nuk janë të lidhur me energji elektrike dhe kërkojnë ndihmë financiare.

Rukije Bytyqi: Janë lagjja pas Pajtimit janë diku 9 familje pa energji elektrike.

Argjend Thaçi: Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Nysret Krasniqi, i cili kërkon ndihmë financiare për djalin të cilin e kish shumë keq i pa lëvizshëm. Ai ka kërkuar së paku barnat me ja siguru. Ne po ja ndajmë 500E mirëpo pas një periudhe me pas parasysh prapë. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është nga Herolinda Hoxha Bytyqi dhe kjo është me kancer dhe kësaj po ja ndajm 500E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është nga Zemë Kastrati i cili kërkon ndihmë financiare për djalë Endritin, shuma e cila më është kërkuar është 3670E. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 450E. Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 450E.

Kërkesa tjetër është nga Nezir Kryeziu, i cili është me kancer. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orë 11:00.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

